



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1300 , datë 14.06.2010

Për

**“Miratimin e Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit dhe Qendrimit te AKEP
per Komentet e Konsultimit Publik”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës __.06. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin e Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit dhe qendrimi ndaj komenteve te konsultimit publik.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 'b', neni 8 i ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
3. VKD nr.920, date 30.07.2009 per miratimin e “**Projekt Rregullore e Akses dhe Interkoneksionit: Keshillim Publik**”.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Bazuar ne percaktimet e VKD nr.920, date 30.07.2009 dhe VKD nr.920/1, date 7.08.2009, dokumenti “Projekt-Rregullorja e re Aksesit dhe Interkoneksionit”, u publikua ne faqen e Internetit te AKEP per konsultim publik ne periudhen 2.08.2009-30.10.2010.
2. Gjatë procesit të konsultimit publik për dokumentin rregullator, kanë paraqitur komentet e tyre palët e interesuara:
 - Vodafone Albania Sh.a.;
 - Albanian Mobile Communications (AMC) Sh.a.;
 - Eagle Mobile Sh.a.;
 - ENET sh.p.k,
3. Dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e Rregullimit Ekonomik përbëhet nga:
 - Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
 - Dokumenti rregullator “Rregullore për Aksesin dhe Interkoneksionin.
 - Komentet e paleve te interesuara per Projekt-Rregulloren dhe Qendrimi i AKEP mbi komentet
 - Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD;
4. Ndryshimet e bera ne rregullore i sherbejne krijimit te nje kuadri rregullator qe synon realizimin e objektiveve te ligjit 9918 per nxitjen e investimeve ne infrastrukture dhe rritjen e konkurrences ne ofrimin e sherbimeve me pakice dhe perfitimet e perdorueve fundore ne RSH nga perdorimi i sherbimeve te komunikimeve elektronike.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë se dokumenti rregullator “ Rregullore për Aksesin dhe Interkoneksionine” eshte një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, KD i AKEP bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme te AKEP, e ndryshuar,